



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

---

**Legjislatura IV**

**Sesioni pranveror**

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 12

Prishtinë, më 21 qershor 2011, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 10

**P R O C E S V E R B A L**

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

**Në mbledhje morën pjesë:** Arben Gashi – kryetar, Mufera Şinik, Behar Selimi, Albulena Haxhiu, Arsim Bajram, Halit Krasniqi, Armend Zemaj, Ardian Gjini dhe Jasmina Zhivkoviq.

**Munguan:** Haki Demolli dhe Ibrahim Makolli.

**Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë:** Valdete Daka – KQZ, Xhemaj Peqani – KQZ, Floriana Shala - OSBE, Rifat Krasniqi – NDI, Sylë Ahmeti – Kosova Sot, Isuf Zejna – KDI, Artan Canhasi – EULEX dhe Fixhrije Dragaj – praktikante.

**Nga Stafi i Komisionit për Legjislacion:** Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

**Mbledhjen e kryesoi:** Arben Gashi, kryetar i Komisionit.

**Rend i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 23. 5. 2011;
3. Shqyrtimi i raportit të Komisionit Qendror të zgjedhjeve për vitin 2010;
4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/ L-004, për Shërbimet e Sigurisë Private;
5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-003 për gjendjen civile;
6. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-005 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/18 për tregtinë e brendshme;
7. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-014 për efikasitetin e energjisë;
8. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-006 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-123 për shoqëritë tregtare;
9. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për nisma legjislative;
10. Të ndryshme.

**Kryetari** konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

### **1. Miratimi i rendit të ditës**

**Kryetari** propozoi që si pika shtesë të rendit të ditës të radhiten edhe

- Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 04/L-008 për Këshillin Ekonomiko-Social;
- Përgatitjet për dëgjim publik për P/L për mbrojtjen e dëshmitarëve;
- Përgatitjet për dëgjim publik për planin e veprimt të Kuvendit për integritet evropiane për vitin 2011.

*Rendi ditës u miratua me ndryshime*

### **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 23. 5. 2011**

**Kryetari** konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 23. 5. 2011 pa vërejtje.

### **3. Shqyrtimi i raportit të Komisionit Qendror të zgjedhjeve për vitin 2010**

**Kryetari** – E ftoi znj. Valdete Daka ta paraqesë raportin e Komisionit Qendror të zgjedhjeve për vitin 2010.

**Valdete Daka**, E njoftoi Komisionin për aktivitetin dhe për pengesat në punën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Ajo në mes të tjerash tha se KQZ-ja gjatë vitit 2010 e ka organizuar përsëritjen e votimit të zgjedhjeve të raundit të dytë për kryetarë të Komunës së Lipjanit, të Komunës së Prizrenit, të mbajtura më 31 janar 2010, si dhe të Komunës së Gjilanit, të mbajtura më 14 mars 2010. Gjithashtu, më 4 prill 2010, janë mbajtur zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar komune në Istog, më 20 qershor 2010 zgjedhjet lokale për kryetar komune në Partesh dhe më 22 nëntor 2010 zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar komune në Rahovec. KQZ-ja i ka organizuar edhe zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kuvendin e Kosovës, të mbajtura më 12 dhjetor, si dhe përsëritjen e zgjedhjeve më 19 janar dhe më 23 janar të vitit 2011. Sfida me të cilat është përballur KQZ-ja, tha se kanë qenë lista e votuesve dhe votimi me kusht. Lista është marrë prej regjistrimit civil, që e marrim nga Ministria e Punëve të Brendshme. Me këtë rast kemi pasur një sërë problemesh për shkak të periudhës së kundërshtimit dhe të konfirmimit të listës së votuesve. Edhe afati prej 38 ditësh për organizimin e zgjedhjeve ka qenë sfidë për KQZ-në.

**Kryetari** - Duke ju referuar raporti tha se KQZ-ja ka pasur probleme të shumta gjatë vitit 2010, sepse është përballur me një dinamikë të madhe. Sfidë kryesore ka qenë organizimi i zgjedhjeve të parakohshme në një afat shumë të shkurtër. Meqë procesi është përballur edhe me defekte të mëdha, edhe rezultati i zgjedhjeve, si rezultat final, është jo i besueshëm. Kërkoj sqarim, duke ju referuar raportit në faqen 12, pika 2.2.7, ku thuhet: “votues të rinj 73 mijë e dyqind e 88 dhe votues që mbushin 18 vjet 35 mijë e 735. Pse del kjo mospërputhje?

**Arsim Bajrami** – Theksoi se në raport janë pasqyruar aktivitetet e KQZ-së, por ai është shumë deskriptiv, shumë pak është kreativ nuk ka rekomandime dhe nuk ka analiza. I ngriti disa çështje, si: riorganizimi KQZ-së, depolitizimi, aftësimi KQZ-së për zgjedhje të shpejta dhe profesionalizimi i stafit.

**Behar Selimi** - E vlerësoi pozitivisht raportin. Veçmas iu referua menaxhimit të buxhetit. Konsideroi se buxheti është menaxhuar mirë. Këtë e dëshmon fakti që ka dalë me suficit nga mallrat dhe shërbimet, kur dihet se në mallrat dhe shërbimet zakonisht harxhohen 90% - 99%. Shtoi se zbatimi i ligjit në vendin tonë po varet shumë nga njerëzit që janë në krye të institucioneve. Sidomos institucionet e pavarura janë nën rrethana të presionit, që janë nga ma të ndryshmet. Shprehu mendimin se suksesi i riorganizimit të KQZ-së varet nga një mekanizëm që i parandalon presionet e mundshme.

**Ardian Gjini** - E ngriti çështjen e depolitizimit të KQZ-së. Në këtë drejtim theksoi se është e nevojshme ndihma juaj. Edhe te çështja e zonave na duhet ndihma juaj, sepse ju keni qenë në terren dhe e dini si të veprohet me zona, a duhet të jenë disa zona apo vetëm një zonë? I përmenda këto çështje sepse raportet duhet të jenë më tepër analizë në mënyrë që të na ndihmojnë.

**Albulena Haxhiu** - Shprehu pakënaqësinë për mënyrën si funksionon KQZ-ja, jo për raportin, sepse po të bazohemi në raport del se zgjedhjet ishin në nivel. Në anën tjetër, ka raporte dhe qëndrime vendore e ndërkombëtare, që thonë se zgjedhjet ishin të organizuara keq e të manipuluar, të përcjella me dhunë e me kërcënime. Si bëhet përzgjedhja e stafit për vizita? Shtoi se shumë qytetarëve, që jetojnë jashtë vendit, u është mohuar e drejta për të votuar. I kemi 515 aplikacione që janë dërguar, ndërsa 1640 janë miratuar. Nga kjo del se 3228 janë hedhur poshtë. Në vazhdim e përmendi çështjen e listave votuese, procesin e rekrutimit të zyrtareve si dhe çështjen e informacioneve që kanë dal nga KQZ-ja në mënyrë të paligjshme.

**Halit Krasniqi** - Ai tha se raporti është paraqitur në mënyrë përmbledhëse dhe lë përshtypje se ka pasur qasje serioze. I mbështes parafolësit për ato mangësi që i evidencuan. Lidhur me organizimin e zgjedhjeve është bërë një organizim mjaft i përkushtuar, por lë për të dëshiruar edhe më tepër, duke filluar që nga certifikimi i subjekteve, plani operacional, që lidhen më shumë me riorganizime që do të bëhen.

**Armend Zemaj** - Tha se raporti është përmbajtjesor. E vlerësoj dhe e jap mendimin tim se mund të përcillet në seancë plenare për diskutim. Shtoi se zgjedhjet lokale të vitit 2009 janë përcjellë me parregullsi. Në veçanti e përmendi Komunën Lipjanit, Komunën e Prizrenit dhe Komunën e Gjilanit. I përmenda këto për shkak se i kanë determinuar zgjedhjet nacionale të vitit 2010. Në bazë të këtij raporti ka dalë konkluzioni, se duhet një reformë zgjedhore. Pastrimi i listave zgjedhore, votimi jashtë Kosovës dhe vjedhja e votave janë çështje që duhet t'u kushtohet kujdes i veçantë.

*Pyetjeve të anëtarëve të Komisionit iu përgjigj znj. Valdete Daka, ndër të tjera sqaroi se KQZ-ja do ta sjellë një aneks të këtij raporti për t'i sqaruar paqartësitë që ekzistojnë në faqen 12 të raportit (2.2.7 Përmbledhje në lidhje me listën e votuesve).*

***Kryetari** konstatoi se Komisioni për Legjislacion me 1 votë “kundër” (Albulena Haxhiu), u pajtua që Kuvendit t’ia paraqesë këtë*

### **R e k o m a n d i m**

1. Të shqyrtohet dhe të miratohet raporti i punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2010.

#### **4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/ L-004, për shërbimet e sigurisë private**

**Kryetari** - E paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për shërbimet e sigurisë private dhe kërkoi nga anëtarët që t’i paraqesin vërejtjet që mund t’i kenë.

***Kryetari** konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri u pajtua që Komisionit FunkSIONAL t’ia paraqesë këtë*

### **Përfundim**

1. Projektligji nr. 04/L-004 për shërbimet e sigurisë private e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e Komisionit FunkSIONAL e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe nuk janë në mospajtim me ligjin e zbatueshëm në Kosovë.
3. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

#### **5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-003 për gjendjen civile**

***Kryetari** konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri u pajtua që Komisionit FunkSIONAL t’ia paraqesë këtë*

### **Përfundim**

1. Projektligji nr. 04/L-003 për gjendjen civile e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e Komisionit FunkSIONAL e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe nuk janë në mospajtim me ligjin e zbatueshëm në Kosovë.
3. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

## **6. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-005 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/18 për tregtinë e brendshme**

**Kryetari** paraqiti vërejtje në amendamentin 8 dhe propozoi t'i rekomandohet Komisionit FunkSIONAL që ky nen të hiqet.

***Kryetari** konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri u pajtua që Komisionit FunkSIONAL t'ia paraqesë këtë*

### ***Përfundim***

- 1) Projektligji nr. 04/L-005 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/18 për tregtinë e brendshme e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
- 2) Amendamentet e Komisionit FunkSIONAL e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe nuk janë në mospajtim me ligjin e zbatueshëm në Kosovë, përveç amendamentit 8 (tetë).
- 3) Komisioni vlerësoi se amendamenti 8 (tetë) nuk ka bazë juridike për miratim dhe i sugjeron Komisionit FunkSIONAL që amendamenti 8 (tetë) të hiqet.
- 4) Projektligji me amendamentet e propozuara, përveç amendamentit 8 (tetë), mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

## **7. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-014 për eficiency e energjisë**

***Kryetari** konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri u pajtua që Komisionit FunkSIONAL t'ia paraqesë këtë*

### ***Përfundim***

1. Projektligji nr. 04/014 për eficiency e energjisë e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e Komisionit FunkSIONAL e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe nuk janë në mospajtim me ligjin e zbatueshëm në Kosovë.
3. Projektligji me amendamentet e propozuara mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

## **8. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-006 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-123 për shoqëritë tregtare**

*Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri u pajtua që Komisionit FunkSIONAL t'ia paraqesë këtë*

### **Përfundim**

1. Projektligji nr. 04/L-006 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-123 për shoqëritë tregtare e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e Komisionit FunkSIONAL e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe nuk janë në mospajtim me ligjin e zbatueshëm në Kosovë.
3. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

## **9. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për nisma legjislative**

Komisioni vlerësoi se Projektligji për nismat legjislative, i plotëson kushtet e përcaktuara që të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në parim.

*Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri u pajtua që Kuvendit t'ia paraqesë këtë*

### **R e k o m a n d i m**

1. Të shqyrtohet dhe të miratohet, në parim, Projektligji nr. 04/L- 025 për nisma legjislative .

## **10. Të ndryshme**

### **a. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-008 për Këshillin Ekonomiko-Social**

*Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri u pajtua që Komisionit FunkSIONAL t'ia paraqesë këtë*

### **Përfundim**

1. Projektligji nr. 04/L-008 për Këshillin Ekonomiko-Social e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

2. Amendamentet e Komisionit FunkSIONAL e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe nuk janë në mospajtim me ligjin e zbatueshëm në Kosovë.
3. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

**b. Përgatitjet për dëgjim publik për P/L për mbrojtjen e dëshmitarëve**

**Kryetari** i njoftoi të pranishmit se është bërë një ndryshim në grupin e punës për P/L për mbrojtjen e dëshmitarëve. Pra në vend të Haki Demollit do të jetë Arned Zemaj. Grupi i punës, në konsultim e sipër, e cakton datën për dëgjim publik.

**c. Përgatitjet për dëgjim publik për planin e veprimit të Kuvendit për integritet evropiane për vitin 2011**

Komisioni vendosi që të mbajë dëgjim publik për planin e veprimit të Kuvendit për integritet evropiane për vitin 2011, më 4. 7. 2011, në orën 11:00

Mbledhja përfundoi në orën 12:10.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit

---

Arben Gashi